

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dokumenti - Ligji për statusin e magjistratëve të hiqet nga rendi i ditës, Bardhi denoncon skandalin: Në Kuvend versioni i ri i pakonsultuar me asnjë...
ADRESA	https://www.syri.net/politike/917252/pd-kerkese-per-ndryshimin-e-rendit-te-dites-te-hiqet-ligji-per-statusin-e-magjistrateteve-ne-kuvend-version-i-ri-i-pakonsultuar-me-asnje/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 07:25:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 07:10:45 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b9f2d56591d28560920d3038353df5f204e9ba0b4ff231d4247609757a8ca93e
TEKSTI	b7738b0e797d418724082ba9fdf71f4a22276f87ea7ca43e59edabf96b8e4149
PAMJA	e17944498a53f8542f78e35258fda184f08120146f6c1c8e9a76e1b8dd6a5a91

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	833cb42376a86835e6be4e67001c1ace4b3ec8176b3e861657f7d4d6772e5669
E MËPARSHMJA	198b49af82489619a2db0b0453f0e9cb99639a857198bb2fd1ceed67cb08a229
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/833cb42376a86835e6be4e67001c1ace4b3ec8176b3e861657f7d4d6772e5669>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



SONILA MEÇO
'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi



ÇIM PEKA
Tradhtia që s'e panë tu ardhë

LAJMI I FUNDIT

KAYO shpenzoi 34 mln euro pa prodhuar asgjë' - PD kërkon ngritjen e Komisionit Hetimor Parlamentar, maxhoranca e rrëzon



më të lexuarat

'Akuza të stisura politikisht', Saiti:
Dënimi i krerëve të UÇK, jo në emër të Kosovës

Zhupa: Nga shkollat me turne te emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin

Specialja: Të akuzuarit vepruan së bashku për një qëllim të përbashkët kriminal, Thaçi ishte anëtar kyç

Nafta këtu më shtrenjtë se në Europë, Bozdo: Situata, emergjente! Qeveria të ndërhyjë me lehtësira fiskale

A e ndryshon vendimi i Hagës mënyrën si duhet parë UÇK-ja? Flet historiani Konrad Clewing! Faji individual, lufta e Kosovës dhe kufijtë...

Ligji për statusin e magjistratëve të hiqet nga rendi i ditës, Bardhi denoncon skandalin: Në Kuvend versioni i ri i pakonsultuar me asnjë...

09:10, 17/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Partia Demokratike i ka bërë kërkesë Kuvendit të ndryshojë rendin e ditës. PD kërkon të hiqet ligji për statusin e magjistratëve dhe të vijojnë konsultimet me sistemin e drejtësisë.

Kërkesa është firmosur nga kreu i grupit parlamentar të PD-së, Gazment Bardhi dhe mban datën e sotme.

PD shpreh shqetësimin se pavarësisht opinioneve të tyre me shkrim, mazhoranca në të gjitha Komisionet Parlamentare, nuk ka marrë në konsideratë asnjë prej shqetësimeve të shprehura nga organet e sistemit të drejtësisë apo shoqatat përfaqësuese të magjistratëve.

Për më tepër "mazhoranca në Komisionin e Ligjeve ka miratuar një version krejt të ri të projektligjit, të depozituar po atë ditë nga një tjetër deputet i Grupit Parlamentar të PS, propozuar si Amendament me nr. 3994 Prot., datë 14.09.2026, por që anëtarëve të Komisionit të Ligjeve i është vënë në dispozicion vetëm ditën e shqyrtimit, pra më datë 15 Shtator 2026.

Madje, Komisioni i Ligjeve ka miratuar projektligjin, në shkelje të procedurës parlamentare, ende pa përfunduar shqyrtimi në Komisionet për dhënie mendimi

dhe pa marrë më parë mendimin e atyre Komisioneve, përkatësisht, Komisionit për të Drejtat e Njeriut. Për më tepër, versioni i ri i projektligjit i miratuar nga Komisioni i Ligjeve dhe që i përcillet për votim seancës plenare, nuk është konsultuar me asnjë prej grupeve të interesit dhe nuk i është bërë transparent atyre"

PD kërkon që Kuvendi të nisë pa asnjë vonesë një proces real, efektiv dhe transparent konsultimi me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe shoqatat përfaqësuese të magistratëve, me qëllim gjetjen e një zgjidhje finale për këtë problematikë dhe reflektimin korrekt të standardeve të përcaktuara në vendimin nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese.

Pjesë nga kërkesa

"Rezultoni se pavarësisht opinioneve të tyre me shkrim, mazhoranca në të gjitha Komisionet Parlamentare, nuk ka marrë në konsideratë asnjë prej shqetësimeve të shprehura nga organet e sistemit të drejtësisë apo shoqatat përfaqësuese të magistratëve.

Për më tepër, mazhoranca në Komisionin e Ligjeve ka miratuar një version krejt të ri të projektligjit, të depozituar po atë ditë nga një tjetër deputet i Grupit Parlamentar të PS, propozuar si Amendament me nr. 3994 Prot., datë 14.09.2026, por që anëtarëve të Komisionit të Ligjeve i është vënë në dispozicion vetëm ditën e shqyrtimit, pra më datë 15 Shtator 2026. Madje, Komisioni i Ligjeve ka miratuar projektligjin, në shkellje të procedurës parlamentare, ende pa përfunduar shqyrtimi në Komisionet për dhënien mendimi dhe pa marrë më parë mendimin e atyre Komisioneve, përkatësisht, Komisionit për të Drejtat e Njeriut. Për më tepër, versioni i ri i projektligjit i miratuar nga Komisioni i Ligjeve dhe që i përcillet për votim seancës plenare, nuk është konsultuar me asnjë prej grupeve të interesit dhe nuk i është bërë transparent atyre.

Nisur nga sa më lart, në mbështetje të nenit 31 të Rregullores së Kuvendit, dhe duke mbajtur në konsideratë se:

1 -Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 15/2026 është shprehur se: "Parimi i shtetit të së drejtës dhe i sigurisë juridike kërkon, në aspektin formal, që elementet dhe parimet që lidhen me sistemin e pagave të magistratëve të përcaktohen me ligj të miratuar nga Kuvendi, përmes një procedure transparente, kurse në aspektin substancial, që parashikimet ligjore të jenë objektive, të parashikueshme, të qëndrueshme dhe transparente, për të përjashtuar ndërhyrje arbitrare të pushtetit ligjvënës ose ekzekutiv gjatë zbatimit të tyre.

Kjo nënkupton edhe që gjatë shqyrtimit dhe miratimit të propozimeve ligjore që prekin drejtpërdrejt garancitë kushtetuese të magistratëve, ku përfshihen pagat e tyre, procesi ligjvënës duhet të përfshijë një analizë tërësore dhe të detajuar të qëllimit të synuar dhe pasojave të pritshme, sikundër duhet të sigurojë edhe pjesëmarrjen aktive të vet gjyqtarëve/magjistratëve ose grupeve që i përfaqësojnë ata. Ky konsultim duhet të jetë, mbi të gjitha, edhe efektiv." (shih vendimin Nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese, §76);

2- Projektligji ka të bëjë me pavarësinë e gjyqësorit dhe me garancitë kushtetuese të magistratëve, ku përfshihen pagat e tyre;

3 Projektligji ka të bëjë me një çështje që ka ngjitur në filtrat kushtetuese disa herë dhe është një shqetësim i mbartur prej vitesh;

4- Projektligji trajton një çështje që lidhet me zbatimin e një vendimi konkret të Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht vendimit nr. 15/2026;

Pagat kanë krijuar një ngërç institucional në funksionimin e sistemit gjyqësor dhe mosmarrëveshjeve ndërmjet pushteve;

(vi) Procesi i konsultimit ka rezultuar të jetë i pamjaftueshëm në kohë dhe jo efektiv;

KËRKOJMË:

1. Në përputhje me nenin 31 të Rregullores së Kuvendit, ndryshimin e Rendit të Ditës së seancës së datës 17 Shtator 2026 dhe heqjen nga Rendi i Ditës i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

2. Në përputhje me nenin 87 të Rregullores së Kuvendit, kalimin e projektligjit për vlerësim edhe në Këshillin e Legjislacionit të Kuvendit të Shqipërisë, me qëllim që të rivlerësojë projektligjin në tërësi në raport me vendimin nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese dhe me qëndrimet e paraqitura nga gjyqësori.

'Thaçi kishte dijeni për krimet, Veseli mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e tyre'

Ligji për statusin e magistratëve të hiqet nga rendi i ditës, Bardhi denoncon skandalin: Në Kuvend versioni i ri i pakonsultuar me asnjë...

Muzeu hebraik në Vlorë/ Nezini: Godina i përket Klubit Labëria, po zhdukët historia

'Vendimi i Hagës, i pabazuar dhe pa fakte', Veseli: Akuzat, të stisura e fabrikua në Serbi

3. Kuvendi të nisë pa asnjë vonesë një proces real, efektiv dhe transparent konsultimi me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe shoqatat përfaqësuese të magistratëve, me qëllim gjetjen e një zgjidhje finale për këtë problematikë dhe reflektimin korrekt të standardeve të përcaktuara në vendimin nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. 4072 Prot.

Tiranë, më 12 / 09 / 2026

Lënda:

Kërkesë për ndryshimin e Rendit të Ditës së seancës së datës 17 Shtator 2026.

Drejtuar:

Z. Niko PELESHI
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë.

Zoti Kryetar i Kuvendit,

Në Rendin e Ditës të datës 17 Shtator 2026, është përfshirë pika nr. 11, shqyrtimi dhe miratimi i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Projektligji trajton një çështje themelore për pavarësinë e gjyqësorit dhe statusin e magistratëve, si dhe ka të bëjë drejtpërdrejtë me zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 15/2026.

Më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj, se çështjet që trajton projektligji janë marrë në shqyrtim disa herë nga ana e Kuvendit të Shqipërisë, dhe në të paktën tre raste zgjidhet e miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë janë konstatuar si antikushtetuese nga ana e Gjykatës Kushtetuese (shih vendimet Nr. 34/2017, Nr. 35/2022 dhe nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese. Për pasojë, kjo është hera e tretë brenda pak viteve që Kuvendi shqyrton të njëjtën çështje.

Rezulton se projektligji është propozim i dy deputetëve të Grupit Parlamentar të PS dhe është depozituar në Kuvend më datë 30 Korrik 2026. Sipas dispozitivit të vendimit nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi kishte afat për të miratuar ndryshimet ligjore deri më 31 Korrik 2026, afat të cilin Kuvendi e tejkaloi, duke shkelur detyrimin për zbatimin e vendimit nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese.

Rezulton se projektligji është depozituar në Kuvend pa një proces efektiv konsultimi me grupet e interesit dhe institucionet e drejtësisë. Më datë 2 Shtator 2026, Kuvendi i është drejtuar disa institucioneve të drejtësisë me kërkesë për dhënie mendimi për projektligjin. Përgjigjia e institucioneve të drejtësisë ka ardhur në datat 14-15 Shtator 2026, kohë në të cilën Komisionet përgjegjëse parlamentare kishin nisur shqyrtimin e projektligjit. Koha në dispozicion për t'u njohur me mendimet e disa prej institucioneve të drejtësisë ishte e pamjaftueshme.

Gjithashtu, vetëm pas kërkesës së Grupit Parlamentar të PD, organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, institucionet e drejtësisë dhe shoqatat e magistratëve u thirrën brenda ditës dhe një kohe shumë të

[Shkarko dokumentin](#)

© SYRI.net

Lexo edhe:

'Ndërkombëtarët s'kanë ndikuar te politikanët', Gecaj: Ka patur presion për çarmatosjen e UÇK

KAYO shpenzoi 34 mln euro pa prodhuar asgjë - PD kërkon ngritjen e Komisionit Hetimor Parlamentar, maxhoranca e rrëzon

Begaj dekreton rrokadën në qeveri/ Firmos shkarkimin e Lamallarit, emërimin e Ervin Demos, 'shkriren e 2 ministrive në 1'

TË NGJASHME

A e ndryshon vendimi i Hagës mënyrën si duhet parë UÇK-ja? Flet historiani Konrad Clewing! Faji individual, lufta e Kosovës dhe kufijtë...

'Akuza të stisura politikisht', Saiti: Dënimi i krerëve të UÇK, jo në emër të Kosovës

'Vendim i rëndë ndaj ish krerëve të UÇK', Bytyçi: Pozitive që s'u njollos lufta me krime kundër njerëzimit

Kreu i Odës Ndërkombëtare të Avokatëve: Aktgjyqimi mund të sfidohet si në fakte, ashtu edhe në ligj

Sot seancë plenare/ 5 ministra japin
llogari në Kuvend - Vendoset edhe për
pagat e magjistratëve

Provokimi i gazetës gjermane: Pra
perëndimi bashkëpunoi me një
kriminel lufte

Mbyllet protesta e 109-të,
protestuesit: Nesër në dyert e
Kuvendit!

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.